



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2019

UDHËZIM

Nr. _____, datë ____ . ____ . 2019

PËR

**PROCEDURAT QË NDIQEN PËR ADMINISTRIMIN E AUTOMJETEVE DHE
MOTOMJETEVE QË KALOJNË NË REZERVAT MATERIALE TË SHETIT SI
PASOJË E KONFISKIMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të neneve 203, 209 dhe 211, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neneve 2, 4/“c”, 6, 10 dhe 11, të ligjit nr. 9900, datë 10.4.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar, si dhe pikës 2/“b”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1128, datë 5.8.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”; dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme Nr.1, datë 09.01.2019 “Për procedurat e kalimit të automjeteve dhe motomjeteve nga mjediset e drejtorive vendore të Policisë së Shtetit dhe ato të Policisë Kufitare dhe migracionit, te drejtoritë rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit”, me qëllim që të ketë unifikim në procedurat që ndiqen për administrimin e automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në Rezervat Materiale të Shtetit si pasojë e konfiskimit,

U D H Ë Z O J:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit është përgjegjëse për marrjen e masave të nevojshme për pranimin dhe marrjen në dorëzim të automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në Rezervat Materiale të Shtetit si pasojë e konfiskimit.
2. Mjetet e konfiskuara kategorizohen duke përcaktuar peshën reale të tyre, nga një komision i ngritur nga ana e drejtorit të përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit. Komisionet për kategorizimin përbëhen nga jo më pak se 5 anëtarë, nga të cilët 3 nga DPRMSH-ja dhe 2 nga FA-ja dhe në përbërjen e tyre marrin pjesë detyrimisht specialistë të fushës (inxhinierë mekanikë etj.). Anëtarët nga FA-ja caktohen nga SHSHPFA-ja me kërkesë të drejtorit të

DPRMSH-së. Kur këta specialistë nuk mund të sigurohen nga strukturat përkatëse, atëherë mund të punësohen ekspertët të jashtëm me kontratë sipas procedurave ligjore.

Komisioni për kategorizimin e mjeteve, duke marrë për bazë këto kritere: viti i prodhimit, kilometrat e përshkruar, gjendja teknike e motorit, normat e harxhimit të karburantit për 100 km, gjendja teknike e pjesëve xhenerike, sistemin elektrik, pamja e jashtme e mjetit dhe tapiceria, norma e emetimit të gazrave, kategorizon mjetet, si më poshtë:

- a) mjete që plotësojnë kushtet teknike për qarkullim;
- b) mjete që do të administrohen në skrap, duke përcaktuar njëkohësisht edhe peshën fizike respektive.

Për mjetet e marra në dorëzim “de jure”, komisioni për kategorizimin e realizon veprimtarinë në pikën ekzistuese të ruajtjes së mjeteve.

Për efekt kontabiliteti, mjetet e konfiskuara, pas marrjes në dorëzim nga Drejtoritë e Rezervave Materiale të Shtetit, do të kontabilizohen me vlerën 1 (një) lek.

3. Komisioni i kategorizimit për përcaktimin e peshës reale fizike të mjeteve që do të administrohen në skrap vepron, si më poshtë:

- a) Përcakton peshën bosh të mjetit sipas librezës teknike, pllakatës metalike apo faqe zyrtare të internetit që përmbajnë të dhënat për peshën e mjeteve;
- b) Bën një klasifikim të mjeteve:
 - nga 3.5 tonë deri në 10 tonë;
 - kamionçinë deri në 3.5 tonë;
 - fugon dhe fuoristradë;
 - autoveturë;
 - motoçikletë;
- c) Peshës teknike bosh i zbret peshën që përfshin: xhamat, pjesët plastike të kroskotit, sediljet, tapiceritë, gomat, parakolpi, stopat, fenerët etj., që, për shkak të natyrës, nuk përfshihen në kategorinë e skrapeve, sipas klasifikimit të mjeteve.

Komisioni i kategorizimit për përcaktimin e peshës reale fizike të mjeteve zbret peshën sipas shkronjës “c”, të pikës 3 të këtij udhëzimi, mbi bazën e një manuali të hartuar nga një grup specifik pune dhe të miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes. Në këtë manual do të përcaktohen edhe përqindjet e metaleve me ngjyrë për secilën kategori të mjeteve motorrike të përcaktuara në shkronjën b të pikës 3. Grupi i punës për hartimin e këtij manuali do të ketë në përbërje 5 anëtarë, specialistë të fushës (inxhinierë mekanikë, inxhinierë elektrikë financiarë etj.) dhe ekspertë vlerësues të jashtëm dhe të pavarur, të përzgjedhur sipas procedurave ligjore. Grupi

i punës brenda 30 ditëve nga marrja e detyrave paraqet manualin për miratim te Ministri i Mbrojtjes.

4. Pas kategorizimit, DPRMSH-ja i dërgon Zyrës Qendrore Kombëtare të Interpol Tirana listën e mjeteve të kategorizuara për qarkullim me numrat e shasisë për konfirmim, nëse mjeti është në kërkim. Në rast se mjetet nuk rezultojnë në kërkim, u nënshtrohen procedurave të shitjes me ankand publik. Në rast se mjetet rezultojnë në kërkim, vijojnë gjendje pranë Rezervave të Shtetit për procedura të mëtejshme.
5. Ministri miraton strukturën përgjegjëse dhe nisjen e procedurave të shitjes me ankand të mjeteve të konfiskuara.
6. Mjetet e kategorizuara sipas pikës 2/“b” të këtij udhëzimi, u shiten vetëm shoqërive me objekt veprimtarie mbledhje dhe përpunim skrap. Me qvllim që autoriteti shitws të sigurohet për tjetwrsimin për skrap (shkatwrrimin/demolimin e mjeteve objekt ankandi), strukturat pwrgegjwse për zhvillimin e ankandit, bazuar në ligjin dhe rregullat e ankandit publik, të parashikojnw në kushtet e veçanta të kontratws klauzola për verifikimin e zbatimit të kontratws në pwrputhje me objektin e saj dhe në zbatim të detyrimeve mjedisore që rrjedhin nga politikat mjedisore në Ministrinw e Mbrojtjes.
Çmimi i shitjes përcaktohet për kilogram skrap, sipas përqindjes së metaleve që përmban çdo mjet sipas manualit të përmendur në pikën 3 të këtij udhëzimi dhe sipas legjislacionit në fuqi mbi ankandin publik.
7. Lista e mjeteve që plotësojnë kushtet teknike për qarkullim, që do të shiten me ankand, sipas legjislacionit në fuqi mbi ankandin publik, së bashku me të dhënat përkatëse, për vitin e prodhimit, markën dhe modelin, i dërgohet nga struktura përgjegjëse për zhvillimin e ankandit, zyrës doganore më të afërt, e cila përdor si burim informacioni buletinet që pasqyrojnë çmimet e shitjes në tregjet evropiane. Të ardhurat kalojnë në buxhetin e shtetit.
8. Mjetet që plotësojnë kushtet teknike për qarkullim, të cilat u janë nënshtuar procedurave të shitjes me ankand publik dhe procedurat e ankandit kanë dështuar, të trajtohen për skrap.
9. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, pas përfundimit të procedurave të ankandit, njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor me listë zyrtare për heqjen nga qarkullimi dhe çregjistrimin e tyre.
10. Mjetet e kaluara në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 203, i Kodit Rrugor, shiten duke i trajtuar si mjetet e konfiskuara.

Për këtë rast, në përfundim të procedurave të shitjes, struktura përgjegjëse për zhvillimin e ankandit njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vlerën e realizuar nga shitja me ankand. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në rast se pas shitjes së mjetit:

- evidenton diferencë të mundshme në lekë, ia kthen atë shkelësit;
- evidenton se vlera e shitjes rezulton më e ulët se vlera e gjobës, atëherë vlera e shitjes konsiderohet e ardhur përfundimtare në buxhetin e shtetit dhe kryen sistemimin e veprimeve dokumentare dhe të rakordimit të kontabilitetit.

11. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, për zbatimin e këtij udhëzimi.

12. Përgjigjet për zbatimin e këtij urdhri sekretari i përgjithshëm dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Olta Xhaçka